

---

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“Power Hand ” SH.P.K**

---

AD

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Power Hand” SH.P.K**

Sot , me date 06 Shkurt 2020, ne Tirane, personi me te dhenat si me poshte:

Alban Dyrmishi, i biri i Yllit , i dtl. 17.09.1992, lindur ne Tirane, dhe banues ne Tirane ne adresen : Rruga 3 Deshmoret, Pallati Maconap, shkalla 1, Ap 54, Yzberisht, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i Pasaportes me nr. BC5880273 dhe nr. Personal J20917002B,

Duke vepruar ne cilesine e Ortakut Themelues, vendos te themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar **“POWER HAND”** dhe vendos te aprovojne kete Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqerise sipas termave dhe kushteve te meposhtme:

**TITULLI I**

**EMRI I SHOQERISE - REGJIMI JURIDIK - SELIA - KOHEZGJATJA**

Neni 1

Emri i Shoqerise

1.1 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, eshte krijuar Shoqeria **“Power Hand” SHPK**, ne vijim referuar si **“Shoqeria”**.

1.2 Shoqeria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.

Neni 2

Regjimi Juridik i Shoqerise

2.1 **“Power Hand” SHPK**, eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

2.2 Aktiviteti i saj eshte i organizuar sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil ne Republiken e Shqiperise.

2.3 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te ndryshoje regjimin e saj juridik, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe dispozitat e Statutit te saj.

2.4 Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

NENI 3

Selia

3.1 Shoqeria ka seline e saj ne adresen: Tirane, Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Ismail Qemali, Pll. 352, Hyrja 1, Ap. nr. 5, Tirane, Shqiperi.

3.2 Shoqeria mund te hape ose te mbylle dege, filiale dhe / ose zyra perfaqesimi brenda Shqiperise dhe / ose jashte vendit, ose te krijojte shoqeri te tjera me Partnere apo Aksionare pjesemarres.

Neni 4

Kohezgjatja

4.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortaku/et e Shoqerise mund te vendosin te kufizojne kohezgjatjen e aktivitetit me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme.



## TITULLI II

### OBJEKTI

#### Neni 5

#### Objekti

5.1 Objekti kryesor i Shoqerise do te perfshije, por nuk do te kufizohet vetem ne veprimtarite e meposhtme:

Qender masazhi dhe relaksi, sauna, fizioterapi, spa, sallon bukurie dhe estetike. Tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve, te materialeve e lendeve te ndryshme te artikujve kozmetike, lendeve te perpunuara e te paperpunuara. Te ushroje veprimtari tjeter te lejuar nga ligji dhe/ose pjesmarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar. Te krijojte filial dhe zyra perfaqesie ne qytete te tjera te shqiperise ose ne shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e tyre.

## TITULLI III

### KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT

#### Neni 6

#### Kapitali i Shoqerise

6.1 Kapitali i shoqerise eshte ne vleren 100 LEK (njqind) i ndare ne 1 (dy) kuota.

Kapitali i shoqerise do te paguhet plotesisht nga ortakët themelues si vijon:  
a) **Alban Dyrmishi**, nenshkruet i 1 (nje) kuote, e barabarte me 100% te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 1 LEK (nje) ,

6.2 Pergjegjesia e Ortakut ndaj paleve te treta per detyrimet e marra persiper nga kompania eshte e kufizuar sipas pjesemarrjes se ortakeve ne kapitalin e shoqerise.

#### Neni 7

#### Transferimi i kuotave

7.1 Transferimi i kuotave te shoqerise ndaj paleve te treta i nenshtrohet se drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te cilet mund ta ushtrrojne kete te drejte sipas kushteve te percaktuara ne nenin 7.2 deri ne nenin 7.6 me poshte.

7.2 Ne rast se nje ortak "Ofruesi" kerkon te shese dhe/ose te transferoje disa ose te gjitha kuotat e tij, ortakët e mbetur ("Ortakët e mbetur") do te kene te drejten e parablerjes ne lidhje me kuoten qe ofrohen per transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve te meposhtme:

(a) Ofruesi do tu dergoje fillimit ortakeve te mbetur nje njoftim me shkrim i cili percakton perqindjen e kuotes se ofruar , cmimin dhe kushtet e tjera te transferimit te cilat duhet te pershijne Identitetin e Bleresit ("OFERTA"), duke ftuar se pari Ortakët e mbetur te blejne aksionet e ofruara;

(b) Ortakët e mbetur do te kene te drejten te blejne kuotat e ofruara perpjestimisht dhe sipas kushteve te ofertes, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje afati prej tridhjetete (30) ditesh pas marrjes se njoftimit te Ofuesit.

7.3 Ne rast se me shume se nje prej Ortakeve te mbetur deshirojne te blejne kuoten e ofruar, secili prej ketyre ortakeve te mbetur do te kete te drejten te bleje kuoten e ofruar perpjestimisht sipas perqindjeve qe zoterojne ne Shoqeri, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje periudhe prej tridhjete (30) ditesh nga marrja e njoftimit sipas se cilit secili prej tyre deshiron te bleje kuoten e ofruar.

7.4 Ne rast se asnje nga ortaket e mbetur nuk deshiron te bleje kuoten e ofruar dhe/ose kane refuzuar te blejne kuoten e ofruar, sipas kushteve te percaktuara ketu, brenda tridhjete diteve nga marrja e ketij njoftimi, Ofruesi do te kete te drejten ti transferoje Kuotat e ofruara nje pale te trete me te njetin cmim qe i eshte ofruar ortakeve te mbetur (sipas kushteve te ofertes fillestare). Nese ky kusht nuk eshte permbushur, Marreveshja per Shitjen e Kuotave me palet e treta do te jete e pavlefshme.

7.5 Ne rast se ndonje ose te gjitha ortaket e shoqerise blen/blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, sic percaktohet me siper, ky transferim do te kryhet sipas kushteve te ofertes.

7.6 Kushtet e parashikuara me siper nuk do te zbatohen ne rast transferimi te kuotave nga nje ortak tek nje shoqeri e cila ndodhet nen kontrollin e ketij ortaku ose ne rast transferimi nga nje ortak tek nje pasardhes ose pasardhes i drejperdrejte i tij ose tek bashkeshorti.

7.7 Dispozitat e neneve 7.1- 7.6 , nuk do te zbatohen ne rast transferimi te bere ne favor te ortakeve te tjere. Megjithate, ne kete rast transferimi duhet ti komunikohet fillimisht me shkrim ortakeve te tjere. Te gjitha njoftimet sipas ketij neni duhet ti dergohen edhe Shoqerise.

#### Neni 8

##### Rritja e Kapitalit

8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te rrise kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti.

8.2 Ne rast te nje rritje te kapitalit, ortaket kane te drejte te nenshkrimin te kuotave nepermjet kontributit ne natyre ose ne te holla, ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitali e shoqerise.

8.3 Nese ndonje nga ortaket refuzoje te drejten nenshkrimin, kapitali mund te nenshkruhet nga ortaket e tjere. Ne kete rast, ortaket e tjere mund te ushtroje te drejten e tyre per nenshkrimin e kapitalit ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitalin e shoqerise.

#### Neni 9

##### Zvogelimi i Kapitalit

9.1 Asambleja e pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast, kapitali nuk mund te reduktohet nen vleren minimale te percaktuar me ligj.

9.2 Ortaket perballen me uljen e kapitalit te shoqerise ne proporcion me kuotat e zoteruara nga secili prej tyre ne kompani.

#### Neni 10

##### Certifikata e pjesemarrjes

10.1 Secili nga ortaket gezon te drejten nje certifikate ne lidhje me perqindjen ne pjesen qe gezon ne kapitalin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotat e mbajtura se bashku nga disa Ortake dhe shperndarja e certifikates per perfaqesuesit e perbashket e anetareve do te konsiderohet e dhene ne interes te te gjitha ortakeve, ne perputhje me dispozitat e ligjit.

1) Asambleja e Pergjithshme;

2) Administratori / s.

## **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

### **1) Asambleja e Pergjithshme**

11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga te gjithë Ortaket e Shoqerise.

11.2 Çdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme per te shprehur mendimin e tij dhe te votoje ne baze te kuotave qe zoteron.

11.3 Ortaku mund te perfaqesohet nga nje person tjetër, jo domosdoshmerisht Ortak/ e, me ane te nje Prokure te Posacme. Ne çdo rast, kjo Prokure e Posacme mund te jepet vetem per nje Mbledhje te caktuar te Asamblese se Pergjithshme, dhe do te jete e vlefshme edhe per mbledhjet pasardhese me te njejtin rend dite. Administratori nuk mund te perfaqesojne Ortakun ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

11.4 Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet ne nje vend te ndryshem nga selia e Shoqerise, ne Republiken e Shqiperise ose jashte vendit.

11.5 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori, sipas nevojave dhe interesave te Shoqerise ose nese kerkohet nga legjislacioni ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme mund te thirret edhe nga cdo Ortak qe zoteron te pakten 10% (dhjete per qind) te pjeses se kapitalit. Ne çdo rast, Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda javes se fundit te muajit Maj, ne menyre qe te diskutoje, te shqyrtoje dhe te miratoje bilancin vjetor te vitit te kaluar fiskal. Mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme, do te mbahet brenda tre muajve nga dita e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar per te diskutuar planin e biznesit dhe çeshtje te tjera.

11.6 Njoftimi per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme do te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, dhe do te dergohet ne adresat e Ortakeve te shoqerise te regjistruara ne Regjistrin e Ortakeve, ose me poste elektronike ne adresat e Ortakeve, ose me poste tek Ortaket se paku 21 ( njezet e nje) dite perpara dates se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

11.7 Njoftimi duhet te permbaje informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen ne rendin e dites dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menyra e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi.

11.8 Asambleja e Pergjithshme do te konsiderohet e mbledhur rregullisht edhe nese nuk ka ndjekur te gjitha formalitetet e thirrjes, nese te gjithë Ortaket qe perfaqesojne pjesen e tere kapitalit te shoqerise jane te pranishem ne mbledhje apo te perfaqesuar nga nje perfaqesues me prokure te posacme, dhe shprehen dakort per te zhvilluar mbledhjen e asamblese pavaresisht parregullsive ne thirrjen e saj.

11.9 Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e njerezve ne vende te ndryshme, dhe mund te mbahet permes telekonferences apo videokonferences, ose mjete te tjera te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjithë pjesemarrësit te mund te identifikohen dhe t'i jepet mundesia per te marre pjese ne diskutimet dhe per te marre pjese ne to.

11.10 Asambleja e Pergjithshme kryesohet nga Kryetari i cili emerohet nga radhet e Ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje. Nese prezenca e nje noteri publik nuk eshte e nevojshme, Asambleja e Pergjithshme do te emeroje nje sekretar, i cili nuk duhet te jete domosdoshmerisht nje nga Ortaket.

11.11 Kryetari i Mbledhjes ka kompetenca te plota per te kontrolluar prokurat e posacme dhe rregullsine e tyre, te drejten e Ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, si dhe per te percaktuar nese Mbledhja eshte thirrur rregullisht dhe nese kuorumi i nevojshem per marrjen e

Vendimeve te vlefshme eshte arritur. Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe per te percaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

11.12 Ne rast se Shoqeria ka vetem nje Ortak qe ka fituar Kuotat e Ortakeve te tjere me ane te nje procesi ligjor dhe zoteron tere kapitalin e shoqerise, vendimet e Ortakut te vetem do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen.

#### **NENI 11- Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme**

11.1 Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket e shoqerise qe zoterojne me shume se 75% (shtadhjete e pese perqind) te Kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vonë se 30( tridhjete) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

11.2 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) percaktimin e politikave tregtare;
- (b) emerimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- (c) emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (d) miratimin e shperblimeve per personat per permendur ne paragrafet (b) dhe (c);
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (f) monitormin dhe mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori;
- (g) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne proceset gjyqesore ndaj Administratorit;

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-së për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

#### **NENI 12 - Përjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **NENI 13 - Administratori**

13.1 Asambleja e Pergjithshme do te caktoj nje (1) personi fizik si Administrator te shoqerise, i cili mund te jete ortak ose jo dhe qe do te jete pergjegjes per ceshtjet e perditshme te Shoqerise sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe me kete Statut.

Administratori ushtron keto detyra:

- (a) menaxhon te shoqerine duke zbatuar politikat siç percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- (b) sigurohet qe te mbahen librat dhe dokumentet e nevojshme kontabel;
- (c) Mban dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise dhe ja paraqet ate Asamblese se Pergjithshme per miratim se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (d) krijon nje sistem paralajmerimi te hershem ne lidhje me zhvillimet qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;
- (e) paraqet te dhenat e shoqerise per t'u regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas rastit;
- (f) raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per punen e Shoqerise;
- (g) cdo detyre tjeter siç percaktohet me ligj ose Statut.

13.2 Administratori emerohet per nje periudhe deri ne 5 (pese) vite dhe me te drejte rizgjedhjeje. Ky emerim prodhon efekte ligjore ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

13.3 Shoqeria merr angazhime me nenshkrimin e vetem te administratorit, sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe ne kete Statut dhe Akt Themelimi.

13.4 Administratori i shoqerise ka te drejten dhe detyrimin per te perfaqesuar Shoqerine ne marredheniet me te tretet.

13.5 Asambleja e Pergjithshme emerom si Administrator te shoqerise, **Z. Alban Dyrmishi, per nje afat 5 (pese) vjecar me te drejte rizgjedhje per te vepruar vepruar ne emer te Shoqerise.** Cdo dhe te gjitha vendimet transfertat bankare si dhe cdo akt tjeter pakufizim, i cili do te kryhet ne emer dhe per llogari te shoqerise, duhet te merret dhe te nenshkruhet nga adminstratori. Shoqeria angazhohet kundrejt te treteve vetem nga veprimet/aktet e nenshkruara nga Administratori.

## **TITULLI IV**

### **VITI FINANCIAR, DIVIDENTI**

#### **NENI 14 - Viti Financiar**

14.1 Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

14.2 Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit ne QKB (Qendra Kombetare e Biznesit) dhe perfundon me 31 Dhjetor te atij viti.

#### **NENI 15 – Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve**

15.1 Permes vendimit te asamblese se pergjithshme shoqeria shperndan dividentin ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve, nese:

- a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimin e saj;

b) shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te paguar detyrimet qe duhet te jene te pagueshme brenda 12 muajsh.

#### **15.2 Kapitalizimi i Fitimeve**

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe ne lidhje me parimet e percaktuara ne nenin 14, te Ligjit 9901, date 14.04.2008 i ndryshuar, Ligj nr. 129/2014, administratori mund te vendose per te kapitalizuar fitimet.

### **TITULLI V**

#### **SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI**

##### **NENI 16 - Prishja-Ndarja-Bashkimi**

16.1 Shoqeria mund te priset per shkaqet e parashikuara me ligj. Ne rast te prishjes, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerone nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar kompetencat reciproke.

16.2 Shoqeria gjithashtu mund te ndahet ose te bashkohet me ane te nje vendimi te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve.

##### **NENI 17 - Likuidimi**

17.1 Ne rast te prishjes shoqeria mund te likuidohet.

17.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja e Zakonshme emerone nje ose me shume likuidatore i cili do te hartoje raportin perfundimtar mbi aktivet dhe pasivet e shoqerise, si dhe procedurat dhe kohet e duhur per likuidim.

17.3 Ne fund te procedurave te likuidimit, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve do te vendose ne lidhje me bilancin perfundimtar, punen e bere nga likuiduesi dhe te perfundoje procesin e likuidimit.

17.4 Me likuidimin e kreditoreve likuiduesit gjithashtu do te shperndajne aktivet e mbetura te Ortakeve ne proporcion me perqindjen qe ata disponojne.

### **TITULLI VI**

#### **NDRYSHME**

##### **NENI 18 - Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarreshjeve**

Çdo mosmarreshje ose mosmarreshjet ndermjet ortakeve ose ne mes tyre ne Shoqeri fillimisht do te zgjidhet ne menyre te brendshme dhe miqesisht. Nese, nje zgjidhje miqesore nuk mund te arrihet brenda 60 ditesh, çeshtja do t'i referohet Gjykatave te Tiranës, me nje proces te rregullt qe do te zhvillohet ne Tirane, Shqiperi.

##### **NENI 19. DISPOZITA TE FUNDIT**

Ky Akt Themelimi dhe Statut u hartua ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.

**ORTAKET THEMELUES  
"POWER HAND" SHPK  
ALBAN DYRMISHI**

*Alban Djurmishi*  
*AD*